

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për trajnim dhe provim për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur civil për mësim të përjetshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 10/15, 145/15, 192/15, 30/16, 120/18 dhe 140/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/24), nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 të datës 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023, nr. 01-197/3 të datës 15.04.2024, nr. 01-109/3 të datës 11.02.2025, nr. 01-157/4 të datës 25.3.2025, nr. 01-121/3 të datës 9.2.2026 dhe nr. 01-181/2 të datës 24.3.2026, Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK **për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues**

I. Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues për realizimin e Programit për trajnim dhe provim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme për modulet në vijim:

1. **Moduli numër 1 – Zbatimi i teknologjisë së informacionit dhe kompjuterëve në menaxhimin e arsimit** – një trajnues në gjuhën maqedonase;
2. **Moduli numër 2 - Teoria e organizimit** – një trajnues në gjuhën maqedonase;
3. **Moduli numër 3 – Njerëzit në organizatë** - një trajnues në gjuhën maqedonase;
4. **Moduli numër 4 – Drejtori si udhëheqës pedagogjik** - një trajnues në gjuhën maqedonase;
5. **Moduli numër 5 – Financa** - një trajnues në gjuhën maqedonase dhe një trajnues në gjuhën shqipe
6. **Moduli numër 6 – Legjislacioni** - një trajnues në gjuhën maqedonase.

II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

Kushte të përgjithshme:

- të kenë të përfunduar së paku arsimin e lartë – niveli VII A i Kornizës Nacionale të Kualifikimeve.
- të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore; dhe
- të kenë përvojë si trajnues në fushën e përmbajtjes së modulit për të cilën konkurrojnë.

Kushte të veçanta:

- të kenë të përfunduara së paku studimet akademike të ciklit të dytë nga fusha përkatëse;
- të kenë të publikuara punime profesionale, përkatësisht shkencore nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilën konkurrojnë dhe
- të kenë përgatitur Plan për realizimin e përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurrojnë, i cili duhet të përmbajë qëllime, përmbajtje, kohëzgjatje, metodologji dhe resurset e nevojshme për secilën temë veç e veç.

III. Kandidatët detyrimisht dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk)
- kopje të certifikatës/diplomës për arsimin e lartë të përfunduar – cikli i parë dhe diplomë për studimet akademike të përfunduara të ciklit të dytë nga fusha përkatëse, ndërsa nëse kandidati posedon edhe studime akademike të ciklit të tretë, dorëzon edhe kopje të certifikatës/diplomës për studimet e doktoraturës – të gjitha dokumentet të vërtetuara te noteri;

- vërtetim për së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në veprimtari edukativo-arsimore ose shkencore, me pozicionin dhe periudhën e angazhimit të cekur qartë, i dorëzuar në origjinal ose në kopje të vërtetuar te noteri;
 - dëshmi për trajnime të realizuara si trajnues nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurrohet;
 - kopje e faqes së parë të punimeve profesionale, përkatësisht shkencore të publikuara nga fusha e përmbajtjes së modulit për të cilin konkurrohet;
 - Plani për realizimin e përmbajtjeve të modulit për të cilin konkurrojnë, i cili duhet të përmbajë qëllime, përmbajtje, kohëzgjatje, metodologji dhe resurset e nevojshme për secilën temë veç e veç.
- IV. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – trajnues bëhet në mënyrë dhe në procedurë të përcaktuara me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.
- V. Kandidatët që do të përzgjidhen si bashkëpunëtorë të jashtëm – trajnues do të angazhohen për periudhë prej 2 (dy) vitesh, llogaritur nga dita e lidhjes së kontratës.
- VI. Afati për paraqitjen e kandidatëve të interesuar është përfundimisht deri më 1.6.2026.
- VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet më së voni brenda afatit prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitje.
- VIII. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i paplotë ose i pavlefshëm nuk do të merret në shqyrtim.
- IX. Fletëparaqitja e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në 14:00) ose me dërgesë postare të rekomanduara në adresën në vijim: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. “Vasil Gjorgov” p.n. 1000 Shkup, me shënim: **“Për konkurs publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – trajnues”**.
- X. Informatat shtesë për konkursin mund të merren në numrin e telefonit 075/300-606, çdo ditë pune, nga ora 10:00 deri në ora 14:00.

QENDRA SHETËRORE E PROVIMEVE